**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Gllogocit**
Zyra e Kryetarit

**01-Nr 010-71395 dt. 17. 12 2019**

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit 08-Nr.030-70789 dt. 13.12.2019, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 72 të Statutit të Komunës së Gllogocit 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008, mori:

**V E N D I M**

I. Lejohet fillimi i procedurave për hapjen e konsultimit publik për Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh, pjesë e fshatit Sankoc, Komuna e Gllogocit- ''Zonë e Mbrojtur në Kategorinë e Monumentit të Natyrës''.

II. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e Vendimit është kompetencë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyres së Kryetarit;
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Arkivit;

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Gllogocit**
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

**08-Nr** -070- 71482 **dt.** 18.12. **2019**

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Gllogocit 01-Nr.070-71395 të datës 17.12.2019, për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Gllogocit të punuar nga grupi punues, paraqesim këtë:

NJOFTIM.
SHPALLJE PUBLIKE

Komuna e Gllogocit fton dhe njofton qytetarët për të shprehur mendimet për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës.

Afati për shprehje të mendimeve, sugjerimeve, komenteve e vërejtjeve për këtë propozim dokument do të jetë nga data 18.12.2019 deri me 17.01.2020.

Vërejtjet, komentet, këshillat, sugjerimet mund t'i drejtoni në email adresat: komuna.drenas@rks-gov.net dhe qenan.maxhuni@rks-gov.net ose mund të i dorëzoni në kopje fizike në objektin e komunës, në zyret e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës në pjesën e Komunës së Gllogocit mund të meret edhe në web faqën: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/.

Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Flutura Avdiu